Gatishmëria e nxënësve për të bërë përpjekje në kërkimin dhe trajtimin e informacionit të reagimit, lidhet me kostot e transaksionit të nevojshme në nivelin e vetë-rregullatorit. Këto kosto transaksioni përfshijnë kostot e përpjekjeve (përpjekja e nevojshme për kërkimin e reagimit), kostot e përballimit (efektet vlerësuese të të tjerëve mbi individin për kërkimin e reagimit), si dhe kostot përfundimtare (implikimet e gabimeve inferenciale që vijnë nga interpretimi i pasaktë i reagimit; Ashford & Cummings, 1983; de

Luque & Sommer, 2000). Avantazhi i kompensimit të këtyre kostove, përbën një zvogëlim të hendekut midis performancës aktuale dhe asaj të dëshiruar ose të pritur. Është ekzistenca e pasigurisë vlerësuese që e bën kërkimin për reagim të denjë për t'u mbështetur për kostot relative (Trope, 1975, 1980). Megjithatë, kur raporti kosto/përfitim bëhet i kufizuar, njerëzit nuk tentojnë të kërkojnë reagim.

Vendimet për të kërkuar ose jo reagim nuk varen nga raporti kosto/përfitim. Në përgjithësi, reagimi është psikologjikisht sigures dhe njerëzit dëshirojnë të marrim reagim rreth performancës së tyre edhe nëse nuk ka asnjë ndikim mbi të (Ashford & Cummings, 1983, fq. 277). Për këtë arsye, është e rëndësishme që të mos ngatërrojmë idenë se reagim-u kërkohe vetëm në rastet kur ndikon në performancë.

Shkalla e sigurisë që nxënësit kanë në saktësinë e përgjigjeve mund të ndikojnë në dhënien dhe marrjen e reagimit. Kullhavy dhe Stock (1989) vunë në dukje se nëse besimi ose siguria e përgjigjes është e lartë dhe përgjigja rezulton të jetë e saktë, reagimi vendoset në plan të dytë. Ndikimi më i lartë i reagimit është atëherë kur nxënësi pret që përgjigja të jetë e saktë, por në fakt rezulton e gabuar. Sikurse Kullhavy dhe Stock theksuan, gabimet e besimit të lartë është pika në të cilën reagimi luan rolin më të madh korrigjues, kjo thjesht pasi individit nuk e studion më materialin në përpjekje për të korrigjuar gabimin (fq.225). Në rast të kundërt, nëse siguria e përgjigjes është e ulët dhe përgjigja rezulton e gabuar, reagimi zakonisht zgjidhet të injorohet. Në këto rrethana, besimi i ulët e vendos nxënësin në një pozicion që kërkon strategji ndihmëse sesa integrim të informacionit të ri në strukturat ekzistuese. Në një situatë të tillë, reagimi duhet të kenë efekt minimal, pavarësisht nëse përgjigja është e saktë ose jo (Kullhavy, 1977, f. 226). Në këtë situatë, integrimi dhe informacioni i mëtejshëm janë më efikasë se reagimi.

Ndjeshitë e vetë-efikasitetit janë ndërmjetës të rëndësishëm në situatat e reagimit. Nga shqyrtimi i tyre kryesor, Kluger dhe DeNisi (1996) arritën në përfundimin se reagimi është efikas në atë shkallë në të cilën ai drejton informacionin drejt vetë-efikasitetit të përmirësuar dhe drejt vetë-rregullimit më efikas, me qëllim që vëmendja të rikthehet në detyrë dhe duke bërë që nxënësit të bëjnë më shumë përpjekje ose angazhim për detyrën. Këta autorë pretenduan se një reagim i tillë mund të sjellë fitime mbresëlënëse në performancë, ndoshta duke tejkaluar 1 sd (fq.278).

Shpeshherë, atributet e nxënësve për suksesin ose dështimin kanë më shumë ndikim sesa realiteti i atij sukcesi ose dështimi. Vetë-efikasiteti dhe performanca mund të ndikohen ndjeshëm nëse nxënësit nuk mund të lidhin reagimin me shkakun e performancës së tyre të dobët. Reagimi vlerësues i paqartë, i cili nuk arrin të specifikojë qartësisht arsyet e suksesit ose të dështimit të nxënësve, mund të përkeqësojë rezultatet negative, të krijojë imazhe të pasigurta për veten, si dhe të sjellë performancë të dobët (Thompson, 1997, 1998, 1999; Thompson & Richardson, 2001). Nga ana tjetër, një reagim i pamërituar i suksesit rrit pasigurinë e rezultatit dhe mund të çojë në rritje të strategjive të vetë-manipulimit (Smith, Snyder, & Handelsman, 1982). Sikurse pretenduan Berglas dhe Jones (1978), vetë-manipulimi buron nga një histori e paqëndrueshme dhe përforcimi kaotik të reagimit, duke sugjeruar se nuk është se historitë e tyre janë të mbushura me dështime të përsëritura; ata janë shpërblyer shumë, por në mënyra dhe raste që i lënë ata thellësisht të pasigurt rreth arsyes së shpërblimit (fq. 407).

Ekzistojnë prova të mjaftueshme që tregojnë se reagimi që atribuon performancën në përpjekje ose aftësi, rrit angazhimin dhe performancën në detyra (Craven, Marsh, & Debus, 1991; Dohrn & Bryan, 1994). Megjithatë, ndikimi i reagimit mbi përpjekjen ose aftësinë mund të jetë në varësi të

rrethanave. Për shembull, Schunk dhe Rice (1991) theksuan nevojën për të analizuar një reagim të tillë në periudha të zgjatura kohore, kjo pasi nxënësit mund të reagojnë në mënyra të ndryshme ndaj reagimit në varësi të fazës së përmbushjes së detyrës. Reagimi i përpjekjes duket të jetë i besueshëm në

fazat e hershme të të nxënës, aty ku nxënësit duhet të përpiqen fort për të pasur sukses. Me zhvillimin e aftësive, suksesi duhet të arrihet më lehtë dhe reagimi për aftësinë mund të bëhet më i besueshëm. Megjithatë, reagimi për aftësinë mund të dëmtojë fokusin e ekipit mbi qëllimet. Për shembull, Mueller dhe Dweck (1998) kryen një seri prej gjashtë studimesh me nxënës të arsimit fillor dhe zbuluan se nxënësit që kishin marrë reagim për aftësinë, ishin më të orientuar ndaj performancës se sa të nxënës, duke raportuar kështu performancë më të dobët dhe kënaqësi më të ulët të detyrave pas një dështimi.

Të kërkuarit ndihmë përbën një aftësi të nxënësit dhe shumë lloje të sjelljes së kërkimit të ndihmës mund të konsiderohen si aspekte të vetë-rregullimit. Është evidentuar një dallim i madh ndërmjet ndihmës instrumentale (kërkimi i sugjerimeve në vend të përgjigjeve) dhe ndihmës ekzekutive së kërkuar (kërkimi i përgjigjeve ose ndihmës së drejtpërdrejtë që shmang kohën ose punën; Nelson-Le Gall, 1981, 1985; Ryan & Pintrich, 1977). Nivelet më të larta të kërkimit të ndihmës instrumentale sjellin reagim në nivelet e vetë-rregullimit, ndërsa kërkimi i ndihmës ekzekutive ka më shumë gjasë të lidhet me nivelin e detyrës dhe shpesh me nivelin e përpunimit. Kur shqyrtojmë mënyrën e zhvillimit të sjelljes instrumentale për të kërkuar ndihmë, duhet të mos harrojmë se ai ndërmjetësohet nga faktorë emocionalë. Shumë nxënës nuk kërkojnë ndihmë për shkak të kërcënimeve të perceptuara për vetëvlerësimin për shkak të drujtjes nga shoqëria (Karabenick & Knapp, 1991; Newman & Schwager, 1993).

Reagimi ndaj Vetes si Individ

Ne përfshijmë një nivel të fundit të reagimit jo sepse është efikas, por sepse shpesh është i pranishëm në klasë dhe përdoret në vend të FT-së, FP-së ose FR-së (Bond, Smith, Baker, & Hattie, 2000). Reagimi personal, i tillë si 'Të lumtë, vajzë' ose 'Përpjekje e suksesshme', zakonisht shpesh vlerësohet pozitive (dhe shpesh negative) duke ndikuar nxënësin (Brophy, 1981). Zakonisht ai përmban pak informacione të lidhura me detyrat dhe rrallë shndërrohet në përfshirje më të lartë, angazhim për qëllimet e mësimit, vetë-efikasitet të zgjeruar ose mirëkuptim në lidhje me detyrën. FS-ja mund të ketë një ndikim në të nxënës vetëm nëse ajo sjell ndryshime në përpjekjen, angazhimin ose ndjesitë e efikasitetit të nxënësve në lidhje me të nxënës ose strategjitë që përdorin kur përpiqen të kuptojnë detyrat. Efektet në nivelin të tyre përkatës janë shumë të pakta, shpesh jo informuese për kryerjen e detyrës, si dhe ndikohen shumë nga vetë-konceptimi të nxënësve mbi të qenurit efikas. Informacioni ka shumë pak vlerë për të sjellë përfitime nga të nxënës. Lavdërimi drejtuar nxënësve nuk të jetë efikas, pasi ai mbart pak informacione që sigurojnë përgjigje për ndonjë nga tri pyetjet dhe shumë shpesh devijon vëmendjen nga detyra. Mungesa e efikasitetit të tij është dëshmuar nga meta-analiza të shumta. Wilkinson (1981) përfundoi një meta-analizë për lavdërimin nga mësuesi dhe arriti në përfundimin se ajo mbart pak, nëse ka, lidhje me arritjet e nxënësit (efekti i përgjithshëm = 0.12). Në mënyrë të ngjashme, Kluger dhe DeNisi (1998) raportuan një përmasë efekti të ulët për lavdërimin (0.09) dhe zbuluan se asnjë lavdërim nuk ka një ndikim më të madh në arritje (0.34).

Sidoqoftë, është e rëndësishme të bëhet dallimi midis lavdërimeve që

drejtojnë vëmendjen nga detyra te vetja (sepse lavdërimet e tilla kanë vlerë të ulët informacioni drejt arritjes dhe të nxënësit) dhe lavdërimet drejtuar përpjekjes, vetë-rregullimit, angazhimit ose proceseve që lidhen me detyrën dhe performancën e saj (p.sh. "Përgëzime, sepse e ke përmbushur me kujdes këtë detyrë duke zbatuar këtë koncept"). Ky lloj vlerësimi mund të ndihmojë në rritjen e vetë-efikasitetit, duke u shndërruar sërish nga nxënësit në ndikim në detyrë dhe duke sjellë kështu

efekte shumë më të mëdha. Sidoqoftë, përmes këtyre meta-analizave, duket se studiuesit jo gjithmonë bëjnë dallimin midis lavdërimit si një përforcues ose shpërblim (për të cilin efekti në arritje është zero ose i kufizuar) dhe lavdërimit të shoqëruar nga informacione në lidhje me proceset ose performancën (i cili ka më shumë ndikim, por sërish i kufizuar).

Këto shqetësime rreth lavdërimeve nuk janë të njëjta me pretendimin se nxënësve nuk u pëlqen të lavdërohen; është krejtësisht e kundërta. Sharp (1985) raportoi se 26% e nxënësve adoleshentë në shembullin e tij preferuan të vlerësoheshin me zë të lartë dhe publikisht kur ata arrinin rezultate në një detyrë akademike, 64% preferuan të lavdëroheshin në heshtje dhe në mënyrë private dhe vetëm 10% preferuan që mësuesit të mos thoshin asgjë. Burnett (2002) dhe Elwell dhe Tiberio (1994) raportuan një përqindje të ngjashme në mesin e nxënësve të arsimit fillor dhe zbuluan se ato preferuan lavdërime për përpjekjen e treguar sesa për aftësitë e larta (veçanërisht kur lavdërimi ishte publik) dhe për arritje në vend të sjelljes. Nga ana tjetër, nëse lavdërimet e bëra publikisht nga një mësuesi jepen në prani të një grupi bashkëmoshatarësh që nuk e vlerësojnë arritjen e shkollës si të vlefshme, mund të perceptohen si ndëshkime nga disa nxënës (Brophy, 1981; Carroll et al., 2001; Carroll, Durkin, Hattie, & Houghton, 1997; White & Jones, 2000).

Lavdërimet mund të jenë kundërproduktive dhe të sjellin pasoja negative në vetëvlerësimin e aftësive të nxënësve. Meyer, Bachman, Hempelmann, Ploger, Spiller (1979) dhe Meyer (1982) drejtuan një sërë studimesh në lidhje me këtë çështje. Këta autorë treguan se nxënësit më të rritur i perceptonin lavdërimet pas suksesit ose reagimit neutral pas dështimit si një tregues se mësuesi e konsideronte aftësinë e tyre si të ulët. Kur kritika jepej pas dështimit dhe reagimi neutral pas suksesit, ata e perceptonin aftësinë e vlerësuar nga mësuesi si të lartë dhe përpjekjen e tyre si të ulët. Megjithatë, të njëjtat efekte nuk ishin të dukshme për nxënësit më të vegjël, të cilët e pranuan lavdërimin pas suksesit si një tregues të aftësisë së lartë dhe kritikën pas dështimit si një shenjë të aftësisë së ulët.

Një pjesë e arsyes së paparashikueshmërisë së lavdërimeve është se shpesh nxënësit zgjedhin reputacion për të kërkuar ose vlerësuar informacionin e reagimit të synuar në nivelin e tyre (p.sh., “Dua të shihem si një nxënës i mirë”, “Unë nuk dua të shihem si një nxënës i mirë”). Nxënësit bëjnë shumë krahasime “në kokën e tyre” (Goethals, Messiek, & Allison, 1991), të cilat mund të zgjidhen, të interpretohen dhe/ose të paragjyken. Pikat e forta dhe performancat pozitive shihen si unike dhe të krijuara vetë, ndërsa pikat e dobëta dhe performancat negative shikohen si të zakonshme tek të tjerët dhe ndoshta të shkaktuara nga të tjerë (Campbell, 1986; Goethals, 1986; Klein, 2001; Suls & Wan, 1987). Nëse reputacionet dhe anshmëri të tilla nuk sjellin investime të tjera në detyrë ose në përdorimin e strategjive më të mira për përmbushjen e detyrës, ato kanë efikasitet të ulët (Carroll et al., 2001).

Një nga vështirësitë me këto krahasime ndodh pasi ato rrallëherë lidhen me detyra specifike, por kanë tendencë të përgjithësohen në nivelin vetjak, duke e bërë kështu të vështirë që të ndryshohen nga mësuesit (Craven, 1997; Hattie, 1992), ndonëse ato ndihmojnë për të shpjeguar se përse reagimi i drejtuar në nivelin vetjak është i reduktuar dhe joefikas në rritjen e angazhimit ose të kuptuarit të detyrave. Zakonisht, këto strategji kanë ndikim negativ në procesin e

të nxënit (Hattie & Marsh, 1995) pasi ato përfshijnë ose drejtojnë vetë-manipulimin, dëshpërimin e mësuar ose krahasimin social. Zakonisht, reagimi përkatës injorohet ose hidhet poshtë, duke sjellë miratimin e qëllimeve të sfidës së ulët.

Përdorimi i katër niveleve dhe tri pyetjeve për të zgjidhur disa çështje problematike me reagimin

Modeli i paraqitur në Figurën 1 është përdorur për të adresuar katër çështje që debatohen zakonisht në lidhje me reagimin: koha e reagimit, efektet e reagimit pozitiv dhe negativ, përdorimi optimal i reagimit në klasë, si dhe roli i vlerësimit në reagim.

Koha e reagimit

Janë bërë shumë kërkime në lidhje me kohën e reagimit, veçanërisht duke krahasuar reagimin e menjëhershëm dhe atë të vonuar. Shumica e këtyre kërkimeve është bërë pa njohur nivelet e ndryshme të reagimit. Për shembull, korrigjimi i menjëhershëm i gabimit gjatë marrjes së detyrës (FT) mund të rezultojë në norma më të shpejta përvetësimi, ndërsa korrigjimi i menjëhershëm i gabimit gjatë krijimit të rrjedhshmërisë mund të dëmtojë mësimin e automatizimit dhe strategjitë e lidhura me të nxënit (FP). Në mënyrë të ngjashme, në meta-analizën e tyre të 53 studimeve, Kulik dhe Kulik (1988) raportuan se në nivelin e detyrës (d.m.th. situatat e testimit), vonesat janë të dobishme (0.36), por në nivelin e procesit (pra angazhimi në përpunimin e aktiviteteve në klasë), reagim-u i menjëhershëm është i dobishëm (0.28) (shiko gjithashtu Bangert-Drowns, Kulik, Kulik, & Morgan, 1991; Brackbill, Blobitt, Davlin, & Wagner, 1963; Schroth & Lund, 1993; Sturges, 1972, 1978; Swindell & Muret, 1993).

Clariana, Wagner dhe Roher Murphy (2000) dhanë një shembull tjetër për të treguar se efektet e reagimit të menjëhershëm mund të jenë të fuqishme për FT-në dhe reagimi i vonuar më i fuqishëm për FP-në. Ata zbuluan se efikasiteti i vonesës krahasuar me reagimin e menjëhershëm ndryshonte si një funksion i vështirësisë së materialeve në testin e tyre të informacionit të mësuar në një serë mësimesh. Përmasat e efektit nga reagimi i vonuar ishin 0.06 për materialet e thjeshta, 0.35 për materialet me vështirësi mesatare dhe 1.17 për materialet e vështira. Këta autorë sugjeruan që materialet e vështira kanë më shumë gjasë të përfshijnë shkallë më të mëdha të përpunimit në lidhje me detyrën dhe reagimi i vonuar jep mundësinë për ta bërë këtë gjë, ndërsa materialet e thjeshta nuk e kërkojnë këtë përpunim, prandaj vonesa është e panevojshme dhe e padëshirueshme.

Efektet e Reagimit Pozitiv dhe Reagimit Negativ

Kluger dhe DeNisi (1996) vunë në dukje se reagimi pozitiv dhe ai negativ mund të kenë efekte të dobishme në procesin e të nxënit, si dhe argumenti i paraqitur në këtë artikull është se qartësimi i këtyre efekteve varet më shumë nga niveli në të cilin synohet dhe përpunohet reagimi sesa nëse është pozitiv ose negativ. Në mënyrë të veçantë, reagimi negativ është më i fuqishëm në nivelin e vetvetes dhe të dy llojet mund të jenë efikasë sikurse FT-ja, por ka efekt diferencial që lidhen me angazhimin, zotërimin ose orientimin e performancës dhe vetë-efikasitetin në nivelin FR.

Në nivelin e vetvetes (FS), tashmë është vërejtur se asnjë lavdërim nuk është më efikas sesa lavdërimi i shoqëruar nga FT-ja. Për më tepër, ka shumë prova që sugjerojnë se reagimi negativ ose diskonfirmimi mund të jenë më të fuqishëm sesa reagim-u pozitiv ose konfirmimi në këtë nivel të vetvetes (Brockner, 1979; Brunit, Huguet, & Monteil, 2000; Campbell &

Fairey, 1985; Hattie, 1992; Janoff-Bulman & Brickman, 1982; Kinch, 1963, 1968; Okun & Sasfy, 1977; Shrauger & Sorman, 1977).

Swann (1985) dhe Swann e Hill (1982) zbuluan se individët do të bëjnë çdo gjë për të konfirmuar vetë-perceptimet e tyre duke u afruar më afër informacionit të reagimit që

përshtatet me pikëpamjen e tyre për vetveten dhe duke e rregulluar mjedisin e tyre për të marrë prova të tjera konfirmuese. Përveç kësaj, individët kanë tendencë të refuzojnë ose të injorojnë raportimet negative të sjelljes së tyre që ndryshojnë nga ato të tyre (Greenwald, 1980; Markus, 1977; Tesser & Campbell, 1983) ose të zbatojnë një kornizë të jashtme të referencës (Marsh, 1987, 1990).

Në nivelin e vetë-rregullimit, angazhimi ndaj qëllimeve përbën ndërmjetësin kryesor për efikasitetin e reagimit pozitiv dhe reagimit negativ. Van-Dijk dhe Kluger (2000, 2001) treguan se reagimi pozitiv rrit motivimin krahasuar me reagimin negativ për një detyrë që njerëzit "duan të bëjnë" dhe ul motivimin në lidhje me reagimin negativ për një detyrë që njerëzit "duhet të bëjnë". Kështu, kur ne jemi të përkushtuar për një qëllim, ka më shumë gjasë të mësojmë si një funksion të reagimit pozitiv, por kur marrim një detyrë për të cilën nuk jemi angazhuar (dhe kështu duhet të bëjmë), ka më shumë gjasë të mësojmë si një funksion të reagimit negativ (ne duhet të nxitemi në terminologjinë më të vjetër të motivimit). Megjithatë, ka gjasë që ky efekt të jetë afatshkurtër pasi mund të sjellë sjellje të ardhshme të shmangies së detyrave.

Në rrethanat në të cilat nxënësit janë të angazhuar për qëllimet, reagimi mund të sjellë një proces të brendshëm krahasimi, i cili përcakton se si individët reagojnë ndaj reagimit.

Pas marrjes së reagimit negativ, individët ndihen më të pakënaqur me nivelin e mëparshëm të performancës, caktojnë qëllime më të larta për performancën e tyre të ardhshme, si dhe performojnë në një nivel më të lartë se ato që marrin reagim pozitiv ose asnjë lloj reagimi. (Podsakoff & Farh, 1989, p. 62)

Megjithatë, reagimi pozitiv mund të rrisë mundësinë që nxënësit t'i kthehen ose të këmbëngulin për një aktivitet dhe të vetë-raportojnë interes më të lartë në aktivitet (Deci et al., 1999).

Madje, ka dhe një efekt ndërveprimi në nivelin FR midis reagimit pozitiv dhe atij negativ dhe vetë-efikasitetit të nxënësve. Swann, Pelham dhe Chidester (1988) zbuluan se për nxënësit me vetë-efikasitet të lartë, reagimet rreth suksesit fillestar mund të tregojnë një talent ose aftësi të mundshme, gjë që çon në përballimin më të mirë të reagimeve të diskonfirmimit. Ata e lidhën reagimin me verifikimet pozitive për veten si nxënës. Si pasojë e reagimit për diskonfirmimin, njerëzit me vetë-efikasitet të lartë bëjnë parashikime më optimiste për performancën e tyre pas dështimit fillestar sesa pas suksesit fillestar, si dhe kërkojnë një përgjigje posaçërisht të pafavorshme për të shkëlqyer në detyra.

Për nxënësit me vetë-efikasitet të ulët, reagimi pozitiv për suksesin fillestar mund të pohojë se ata kanë mangësi që duhen korrigjuar, gjë që mund të çojë sjellë një larmi reagimesh. Një reagim mund të jetë angazhimi i mëtejshëm për të korrigjuar këto "mangësi" për të arritur një nivel të pranueshëm të performancës, i cili do t'u sigurojë mbrojtje kundër dështimit. Përndryshe, këta nxënës mund të shmangin detyrat dhe reagimet pas suksesit fillestar, sepse një sukses i tillë nënkupton se ata kanë arritur tashmë një nivel të përshtatshëm performance dhe testet e mëtejshme thjesht sjellin rrezikun e diskonfirmimit të rezultatit të favorshëm (shpesh i fituar me vështirësi).

Reagimet diskonfirmuese mund të ndikojnë edhe negativisht në motivimin

dhe performancën e mëvonshme për nxënës me vetë-efikas të ulët (Brockner, Derr, & Laing, 1987; Moreland & Sweeney, 1984). Kernis, Brockner dhe Frankel (1989) argumentuan se njerëzit me vetë-efikasitet të ulët kanë më shumë gjasë të përgjigjen ndaj reagimeve negative

duke përjetuar një ndikim negativ, duke shfaqur më pak motivim për detyrën vijuese, si dhe duke ia atribuar reagimin më pak përpjekjes dhe më shumë aftësisë.

Në nivelin e detyrës (FT), tashmë është vërejtur fuqia e reagimit korrigjues për përmirësimin e të nxënit, në mënyrë të veçantë kur mësohen aftësi ose detyra të reja. Diskonformimi me informacionin korrigjues mund të jetë efikas, por diskonformimi pa këtë informacion nuk është i dobishëm, pasi nuk jep informacione lidhur me veprimet që duhet bërë apo mënyrën e reagimit në të ardhmen (Breakwell, 1983; Weiner, 1974a, 1974b, 1977). Tashmë është e ditur se FT-ja mund të injorohet nga nxënësit nëse nuk jepet në mënyrën e duhur ose në njohuritë e nxënësve janë të pamjaftueshme për të akomoduar informacion shtesë për reagimin. Howie, Sy, Ford dhe Vicente (2000) zbuluan se ishte pikërisht prezantimi i dobët (ose mungesa e vlerës së informacionit në reagim) dhe jo njohuritë e gabuara të nxënësve që shpjegonin më mirë fuqinë e ulët të disa informacioneve për reagimin.

Reagimi dhe klasat

Ky model reagimi thekson kërkesat e mësuesve për të dhënë mësim në mënyrën e duhur. Si fillim, ata duhet të ndërmarrin udhëzime efikase. Për ta përsëritur, reagimi lidhet me atë që ndodh së dyti dhe për ta bërë atë më efikas, mësuesit duhet të bëjnë gjykime të duhura për kohën, mënyrën dhe në çfarë niveli duhet të jepet reagimi i përshtatshëm dhe për cilën nga tri pyetjet duhet të adresohet.

Përveçse të theksohet se është e ulët, frekuenca e reagimeve në klasa është e vështirë të dokumentohet. Bond et al. (2000) dokumentoi intensivisht jetën e përditshme të 65 mësuesve (gjysma e të cilëve kishin kaluar certifikimin e bordit kombëtar dhe gjysma jo). Megjithëse reagimi ishte një nga variablat që diskriminonte më së shumti ata të certifikuar ose jo si mësues “të realizuar”, frekuenca e FT-së ishte e ulët në klasat e të dy grupeve (forma më e zakonshme e reagimit ishte lavdërimi).

Kur jepet reagimi, ka gjasë të jetë i lidhur me veten (FS) ose i lidhur me detyrën korrigjuese (FT), si dhe të ndikohet nga perceptimet e nevojave të nxënësve. Mësuesit lavdërojnë më shumë nxënësit e “dobët” (FS) dhe reagimi FR në të shumtën e rasteve është negativ (Blöte, 1995). Reagimet e mësuesve për djemtë janë më të lidhura me mungesën e përpjekjeve ose sjelljen e dobët, ndërsa reagimet ndaj vajzave kanë të bëjnë më shumë me atributet e aftësive (Dweck, Davidson, Nelson, & Enns, 1978).

Reagimet nuk vetëm janë dhënë, por edhe janë marrë në mënyra të ndryshme (Diehl & Stermann, 1995; Patch & Stermann, 1993; Stermann, 1989). De Luque dhe Sommer (2000) zbuluan se nxënësit nga kulturat kolektivistike (p.sh., Azia konfuciane, kombet e Paqësorisë të Jugut) preferuan reagime indirekte dhe të nënkuptuara, më shumë reagime të përqendruara në grup dhe asnjë reagim të nivelit vetjak. Nxënësit nga kulturat individualiste (p.sh., Shtetet e Bashkuara) preferuan më shumë reagime të drejtpërdrejta të lidhura veçanërisht me përpjekjet, kishin më shumë gjasë të përdornin pyetje të drejtpërdrejta për të kërkuar reagim, si dhe preferuan më shumë reagime të përqendruar te vetja.

Klima në klasë është kritike, sidomos nëse diskonfirmimi dhe reagimi korrigjues në çdo nivel mirëpritet dhe përdoret nga nxënësit (dhe mësuesit).

Gabimet dhe diskonformimi janë më të fuqishëm në klimat ku vërehen se paraprijnë mësimin e ardhshëm, veçanërisht në lidhje me përpunimin dhe rregullimin. Angazhimi i nxënësve në mësim ka gjasë të kufizohet nga dimensionet vlerësuese të mësimave në klasë, sepse ekziston rreziku personal i përgjigjes në publik dhe dështimit. Shpeshherë, niveli i rrezikut përcaktohet nga

Mundësia që ka nxënësi për të dhënë një përgjigje nga dhe nga klima e përgjegjësisë e krijuar nga mësuesi dhe nxënësit e tjerë (Alton-Lee & Nuttall, 1990, 1998; Doyle, 1983). Zakonisht, nxënësit përgjigjen vetëm atëherë kur janë të sigurt që mund të përgjigjen saktë, gjë e cila tregon shpesh se përgjigja e pyetjes së bërë është mësuar. Gabimet dhe të mësuarit prej tyre rrallëherë mirëpreten nga nxënësit.

Thjesht dhënia e më shumë reagimeve nuk përbën përgjigje, sepse është e nevojshme të merret në konsideratë natyra e reagimit, koha dhe mënyra sesi nxënësi e "pranon" këtë reagim (ose, për të thënë më mirë, kërkon në mënyrë aktive reagim). Siç kemi theksuar tashmë, nxënësit mund të gjykojnë dhe të zgjedhin informacionin e reagimit. Mënyra përmes së cilës individët interpretojnë informacionin e reagimit është çelësi për zhvillimin e koncepteve pozitive dhe të vlefshme të vetë-efikasitetit në lidhje me të nxënit, gjë e cila në disa raste çon në të nxënit e mëtejshëm. Mësimdhënësit duhet ta shikojnë reagimin nga këndvështrimi i individëve të përfshirë në mësim dhe të bëhen aktiv në ofrimin e informacionit për adresimin e tri pyetjeve të reagimeve dhe zhvillimin e mënyrave që nxënësit t'i bëjnë vetë këto pyetje. Shumë shpesh, nxënësit e shohin reagimin si përgjegjësi të dikujt tjetër, zakonisht mësuesve, detyra e të cilit është të ofrojë informacion reagimi, duke vendosur mbi ecurinë e nxënësve, cilat janë qëllimet dhe çfarë të bëjnë më tej.

Reagimi dhe Vlerësimi

Nga ky shqyrtim i reagimit për vlerësimin në klasë, ka disa implikime madhore. Vlerësimi mund të konsiderohet si veprimtari që u siguron mësuesve dhe/ose nxënësve informacion reagimi në lidhje me një ose më shumë nga tri pyetjet e reagimit (në nivelin FT, FP ose FR). Një përkufizim i tillë vendos theksin në hartimin e detyrave të vlerësimit që ofrojnë informacion dhe interpretime në lidhje me mospërputhjen midis statusit aktual dhe qëllimeve mësimore në cilindo prej tri niveleve: në lidhje me detyrat, për proceset ose strategjitë për të kuptuar detyrat, si dhe në lidhje me rregulloren, angazhimin dhe besimin për t'u përkushtuar më shumë në procesin e të nxënit. Kjo bie ndesh me përkufizimin më të zakonshëm të vlerësimit, një aktivitet i përdorur për të vlerësuar nivelet e aftësive të nxënësve. Ky përkufizim i zakonshëm vendos më shumë theks në përshtatshmërinë e rezultateve (dhe më pak në interpretimin e tyre). Crooks (1988) dhe Black dhe Wiliam (1998) treguan se ka pak prova që testimi i tillë në klasë të ketë ndihmuar në procesin e të nxënit. Për shembull, Black dhe William shqyrtuan 578 publikime në lidhje me rolin e vlerësimit në procesin e të nxënit dhe dolën në përfundimin se vlerësimi në klasë zakonisht nxit të nxënit e jashtëm dhe të drejtpërdrejtë, duke u përqendruar në rikujtimin e detajeve të izoluara, zakonisht artikuj të njohurive të cilat nxënësit harrojnë shumë shpejt...mësuesit nuk i rishikojnë pyetjet e vlerësimit që ato përdorin dhe nuk i diskutojnë ato në mënyrë kritike me kolegët, prandaj nuk reflektohet mjaftueshëm mbi atë që vlerësohet.

(fq.17)

Shumë shpesh, fuqia e reagimit vlerësues ka si qëllim të "drejtojë"

nxënësit drejt qëllimeve (shpesh të paspecifikuara) ose që "të bëjnë më shumë" ose "të dalin më mirë". Studentët marrin pak informacione për reagime në këto raste, kryesisht sepse reagimi i vlerësimit nuk adreson tri pyetjet kryesore dhe rrallëherë një reagim i tillë sjell përmirësimin e proceseve (FP) dhe atributet metakognitive (FR) të detyrës. Për më tepër, mësuesit shpesh i konsiderojnë reagimet e vlerësimit si deklarata për nxënësit, jo për mësimet e tyre (Timperley & Wiseman, 2002). kështu, përfitimet e reagimeve në klasë nga testimi i tillë shpesh reduktohen.

Ekzistojnë shumë mënyra përmes të cilave mësuesit mund t'u japin përgjigje nxënësve dhe që nxënësit të marrin reagim nga mësuesit, bashkëmoshatarët dhe burime të tjera. Implikimi nuk qëndron në faktin se duhet të përdorim automatikisht më shumë teste (Bangert-Drowns, Kulik, & Kulik, 1991). Përkundrazi, për nxënësit do të thotë të merren informacione rreth asaj se si dhe çfarë kuptojnë dhe keqkuptojnë, të gjejnë udhëzime dhe strategji që ata duhet të ndërmarrin për t'u përmirësuar, si dhe të kërkojnë ndihmë për të kuptuar qëllimet e të nxënësve. Për mësuesit, kjo gjë nënkupton krijimin e aktiviteteve dhe pyetjeve që u japin përgjigje për efikasitetin e mësimit të tyre, në mënyrë të veçantë që ata të dinë se çfarë të bëjnë tjetër. Vlerësimet mund të kryejnë të gjitha këto funksione reaguese, por shumë shpesh, ato nuk kanë përbërje reagim efikas për nxënësit ose mësuesit.

Përfundime

Reagimi i referohet informacionit të dhënë nga një agjent (si p.sh. mësuesi, bashkëmoshatar, libri, prindi, vetvetja, përvoja) në lidhje me aspektet e performancës ose të kuptuarit e dikujt. Zakonisht ndodh pas udhëzimit që kërkon të sigurojë njohuri dhe aftësi ose të zhvillojë qëndrime të veçanta. Modeli i propozuar në këtë artikull identifikon tri pyetje kryesore të reagimit: Drejt cilës rrugë po shkoj? A po përparoj? dhe Cili është hapi tjetër? Përgjigjet e këtyre pyetjeve përmirësojnë të nxënës kur ekziston një mospërputhje midis asaj që kuptohet dhe asaj që synohet të kuptohet. Mund të rrisë përpjekjen, motivimin ose angazhimin për të zvogëluar këtë mospërputhje, si dhe/ose mund të rrisë proceset e kërkimit dhe detyrave që sjellin të nxënës (duke zvogëluar këtë mospërputhje). Reagimi bën pjesë në ndikimet më kritike në të nxënës e studentit. Synimi kryesor i procesit edukativo-arsimor është të ndihmojë në identifikimin e këtyre hendqeve ("A po përparoj" në lidhje me "Drejt cilës rrugë po shkoj") dhe të sigurojë korrigjim në favor të hapave të tjerë ("Cili është hapi tjetër?").

Modeli dallon katër nivelet e reagimeve: nivelet e detyrës, përpunimit, rregullimit dhe vetvetes. Reagimet efikase në nivelin e detyrës, procesit dhe vetë-rregullimit janë të ndërlydhura. FT-ja është më e fuqishme nëse rezulton nga interpretimet e gabimeve dhe jo nga mungesa e të kuptuarit. Ai është më efikas kur ndihmon në krijimin e sugjerimeve dhe informacioneve në lidhje me hipotezën dhe idetë e gabuara dhe më pas çon në zhvillimin e strategjive më efikase për përpunimin dhe të kuptuarit e materialit. Reagimi në nivelin e procesit është më i dobishëm nëse i ndihmon nxënës të hedhin poshtë hipotezat e gabuara dhe të ofrojnë sugjerime për udhëzime kërkimi dhe strategji. Sugjerime të tilla sensibilizojnë nxënës për informacionin mbi kompetencën ose strategjinë në një detyrë ose situatë. Në mënyrë ideale, ai kalon nga detyra në proceset ose të kuptuarit e nevojshëm për të mësuar detyrën për rregullimin për të vazhduar përtej detyrës në detyra dhe qëllime më sfiduese. Ky proces sjell besim më të lartë dhe përpjekje më të madhe. Kjo rrjedhë zakonisht ndodh pasi nxënës fitojnë rrjedhshmëri dhe zotësi më të madhe. Reagimet që ndjekin vetë-rregullimin janë të fuqishme deri në shkallën që çon drejt angazhimit ose investimit të mëtejshëm në detyrë, drejt vetë-efikasitetit të përmirësuar dhe atributëve se reagimi është i merituar dhe i fituar me të drejtë. Kur reagimi përqendrohet në proceset rregullatore të nevojshme për t'u përfshirë një detyrë,

besimi i nxënësve për rëndësinë e përpjekjes dhe konceptimet e tyre të të nxënit mund të jenë moderatorë të rëndësishëm në procesin e të nxënit.

Nga ana tjetër, reagimet në nivelin vetjak ose personal (zakonisht lavdërimi), rrallëherë janë efikase. Lavdërimet rrallë u adresohen tri pyetjet të reagimeve dhe kjo gjë është joefikase në përmirësimin e procesi të të nxënit. Kur reagimi përqendrohet

te vetja, përpikuni të shmangni rreziqet e përfshira në trajtimin e detyrave sfiduese, të minimizoni përpjekjet dhe të keni një frikë të lartë dështimi (Black & Wiliam, 1998) për të minimizuar rrezikun për veten.

Tri pyetjet e reagimeve nuk interpretohen ose zbatohen në mënyrë lineare dhe kufijtë midis tyre janë të paqartë. Ndonëse është e rëndësishme të dimë qëllimet, përvojat e të mësuarit nuk fillojnë domosdoshmërisht me pyetjet "Cilat janë qëllimet?", kjo pasi këto mund të zbulohen (zakonisht në mënyra më specifike) ndërsa ndërmarrim detyra të veçanta. Qëllimet mund të jenë të shumta dhe shpesh konkurruese, dhe shumë nga të nxënit e përfutur mund të sjellë krijimin e opsioneve për të arritur qëllimet, duke peshuar të mirat dhe të këqijat e opsioneve, duke marrë parasysh gjasat që një veprim i caktuar të çojë në qëllime, si dhe të mësuarit në lidhje me dhe vlerësimin e pasojave të arritjes së qëllimeve. Kështu qëllimet mund të jenë vazhdimisht në diskutim dhe reagimet lidhura me pyetjen "A po përparoj?" mund të ndihmojnë në këto konsiderata të lidhura me qëllimet. Në mënyrë të ngjashme, përgjigja për pyetjen "Cili është hapi tjetër?" mund të jetë askund, nëse qëllimi është i pandryshueshëm, "rezultati" është angazhimi i mëtejshëm me të njëjtat ose detyra të ngjashme, ose nxënësi beson se përgjigja është "çdo gjë që më thotë mësuesi të bëj". Reagime të tilla zakonisht tregojnë për vetë-rregullim të ulët ose regjime tepër mbizotëruese në klasë. Përgjigja për pyetjen "Cili është hapi tjetër?" duhet të adresohet më shumë drejt përsosjes dhe kërimit të qëllimeve më sfiduese, sepse këto kanë besimin më të lartë për të çuar në arritje më të mëdha.

Duhet të jetë e qartë se dhënia dhe marrja e reagimit kërkon shumë aftësi nga nxënësit dhe mësuesit. Modeli i përparuar në këtë artikull nuk kërkon thjesht një rutinë stimuluese dhe përgjigje, por kërkon aftësi të lartë në zhvillimin e një klime në klasë, aftësinë për t'u marrë me kompleksitetet e gjykimeve të shumta dhe të kuptuarit e thellë të lëndës për të qenë të gatshëm për të siguruar reagime në lidhje me detyrat ose marrëdhëniet midis ideve, gatishmërinë për të nxitur vetë-rregullimin, dhe duke pasur kohën për të siguruar reagime para ndikimi të zhgënjimit. Mundësia për t'i kushtuar kohë dhe vëmendje reagimit ndihmohet kur mësuesit automatizojnë shumë detyra të tjera në klasë dhe ofrojnë mundësi të pasura të të nxënit për të gjithë nxënësit, duke pasur kështu kohën dhe burimet për t'u përgjigjur reagimeve (Hattie & Jaeger, 1998).

Modeli përcakton në mënyrë të vendosur që reagimet përfshijnë dhënien dhe marrjen (nga mësuesit dhe/ose nga nxënësit), dhe midis tyre mund të ketë boshllëqe. Nxënësit ndërtojnë botën e tyre të të nxënit dhe klasave dhe kjo përbën argumentin kryesor të këtij artikulli që është thelbësore që mësuesit të kuptojnë dhe vlerësojnë që dhënia e reagimit është vetëm një pjesë e ekuacionit. Në mënyrë të ngjashme, disa detyra mund të sjellin reagime më efikase nga mësuesit, nxënësit ose të dy bashkë. Të nxënit mund të përmirësohet në atë shkallë sa që nxënësit të ndajnë qëllimet sfiduese të të nxënit, të zbatojnë strategji të vetëvlerësimit dhe vlerësimit, si dhe të zhvillojnë procedura të zbulimit të gabimit dhe të vetë-efikasitetit më të lartë për të trajtuar detyra më sfiduese që çojnë në zotërimin dhe të kuptuarit e mësimeve. Nëse këto efekte ndodhin, strategjitë e vetë nxënësve dhe ndihma e kërimit mund të veprojnë si ndërmjetësues. Nxënësit që dëshirojnë të konfirmojnë vetëbesimin pozitiv sesa të përqendrohen në qëllimet e të nxënit ka më shumë gjasë të zbatojnë ose të kërkojnë një reagim që maksimizon vetëvlerësimet pozitive dhe/ose minimizon

vetëvlerësimet negative. Është identifikuar një numër strategjish të vetë-identifikuara që pengojnë efektet e reagimit në procesin e të nxënit, dhe reagimi është efikas vetëm kur nxënësit u përkushtohen qëllimeve të të nxënit dhe kur reagimi lidhet me arritjet e të nxënit (Crocker & Wolfe, 2001). Një detyrë e rëndësishme për mësuesit dhe prindërit

është që qëllimet akademike të jenë të qarta për të gjithë nxënësit, pasi nxënësit që janë të përgatitur të pyesin ose reflektojnë mbi ato që dinë dhe kuptojnë, kanë më shumë gjasë të kërkojnë reagime konfirmuese dhe/ose diskonfirmuese që lejojnë mundësi më të mira për të nxënësit.

Megjithatë, reagimi nuk është “përgjigja”; në të vërtetë, është një përgjigje e fuqishme. Nëse nxënësit nuk janë efikasë, mësuesi duhet të japë detaje përmes udhëzimeve në vend të reagimit për konceptet që nuk janë kuptuar qartë. Nëse reagimi drejtohet në nivelin e duhur, ai mund t’i ndihmojë nxënësit të kuptojnë, të përfshihen ose të zhvillojnë strategji efikase për të përpunuar informacionin e synuar. Për të qenë efikas, reagimi duhet të jetë i qartë, i qëllimshëm, i kuptueshëm dhe në përputhje me njohuritë e mëparshme të nxënësve, si dhe të bëjë lidhje logjike. Gjithashtu, ai duhet të nxisë përpunimin aktiv të informacionit nga ana e nxënësve, të ketë kompleksitet të ulët të detyrave, të lidhet me qëllime specifike dhe të qarta, si dhe të përbëjë kërcënim të ulët për personin në nivelin e vetvetes. Diskriminuesi kryesor është nëse ai adreson qartë detyrën, proceset dhe/ose rregullimin dhe jo në nivelin e vetvetes. Këto kushte theksojnë rëndësinë e klimave në klasë që nxisin bashkëmoshatarët dhe vetëvlerësimin, si dhe lejojnë mësimin nga gabimet.

Ekzistojnë disa implikime për hartimin e vlerësimeve. Shpeshherë, vlerësimet përdoren për të siguruar ilustrime të të nxënësit në vend që të japin informacione që mund të përdoren nga nxënësit ose mësuesit e tyre për të adresuar tri pyetjet për reagimin. Sigurisht, një përfundim kritik është se mësuesit duhet të kërkojnë dhe të mësojnë nga reagimet (si përgjigjet e nxënësve në teste) po aq sa edhe nxënësit, dhe ai ka vlerë vetëm nëse vlerësimi jep një mësim të tillë. Shpesh, shumica e vlerësimeve aktuale japin reagime minimale, pasi ato mbështeten në kujtesë dhe përdoren si termometra të përgjegjësisë së jashtme sesa si pajisje reagimi që janë thelbësore në procesin e mësimdhënies dhe të nxënësit. Ato që kanë rëndësi, janë informacionet e reagimit dhe interpretimet nga vlerësimet, jo notat. Në shumë raste, testimi përdoret si mjet për të gjykuar nëse ndryshimi ka ndodhur dhe jo si një mekanizëm për të forcuar dhe konsoliduar më tej të nxënësit nga nga mësuesit ose nxënësit. Kostot e testeve të përgjegjësisë të lidhura me termometrin janë të larta, dhe kthimet e reagimeve janë minimale (Shepard et al., 1996).

Nga ana tjetër, nëse reagimi kombinohet me udhëzim efikas në klasa, ai mund të ketë fuqi në përmirësimin e të nxënësit. Siç vuri në dukje Kluger dhe DeNisi (1996), një ndërhyrje reaguese parashikonte një detyrë të njohur që përmbante sugjerime që mbështesin mësimin, tërheqjen e vëmendjes ndaj mospërrputhjeve standarde të reagimit në nivelin e detyrës dhe pavlefshmërinë e shenjave që vëmendja e drejtpërdrejtë ndaj vetvetes ka gjasë të japë rezultate mbresëlënëse në performancën e nxënësve. Megjithatë, duhet theksuar se në rrethana të veçanta, udhëzimi është më efikas se reagimi. Reagimet mund të ndërtohen vetëm mbi diçka; nuk janë të dobishme nëse nuk ka të nxënë fillestar ose informacion të jashtëm. Reagimi ndodh së dyti dhe është një nga ndikimet më të fuqishme në procesin e të nxënësit, ndodh shumë rrallë dhe duhet të hulumtohet më thellësisht duke vlerësuar në mënyrë cilësore dhe sasiore se si reagimet funksionojnë në klasë dhe në procesin e të nxënësit.

Referenca

- Airasian, P. W. (1997). *Classroom assessment [Vlerësimi në klasë]* (bot. 3^{te}). Nju Jork: McGraw-Hill.
- Alton-Lee, A., & Nuttall, G. (1990). Research on teaching and learning: Thirty years of change. [Hulumtim mbi mësimdhënien dhe mësimnxënien: tridhjetë vjet ndryshime.] *Elementary School Journal*, [Revista Shkencore për Shkollën Fillore] 90(5), 547—570.

- Alton-Lee, A., & Nuthall, G. (1998). *Inclusive instructional design: Theoretical principles emerging from the Understanding Learning and Teaching Project* [Projekti i gjithëpërfshirës bazuar në udhëzime: Parimet teorike që lindin nga Projekti i të Kuptuarit, Mësimnxënies dhe Mësimdhënies] (Report to the Ministry of Education, Understanding Learning and Teaching Project 3 [Raport për Ministrinë e Arsimit, Projekti i të Kuptuarit, Mësimdhënies dhe Mësimnxënies 3]). Uellington, Zelandë e Re: Ministria e Arsimit, Sektori i Kërkimit.
- Ashford, S. J., & Cummings, L. L. (1983). Feedback as an individual resource: Personal strategies of creating information. [Reagimi si një burim individual: Strategjitë personale të krijimit të informacionit] *Organizational Behavior and Human Performance* [Sjellja Organizative dhe Performanca Njerëzore], 32, 376-398.
- Balzer, W. K., Doherty, M. E., & O'Connor, R., Jr. (1989). Effects of cognitive feedback on performance. [Efektet e reagimit njohës mbi performancën] *Psychological Bulletin* [Buletini Psikologjik, 106 3], 410-433.
- Bandura, A. (1982). Self efficacy mechanism in human agency. [Mekanizmi i vetë-efikasitetit në veprimin njerëzor] *American Psychologist* [Psikologu Amerikan], 37 122—147.
- Bandura, A. (1986). *Social foundations of thought and action: A social cognitive theory*. [Bazat shoqërore të mendimit dhe veprimit: Një teori njohëse shoqërore] Englewood Cliffs, NJ: Prentice Hall.
- Bangert-Drowns, R. L., Kulik, J. A., & Kulik, C. C. (1991). Effects of frequent classroom testing. [Efektet e testimit të shpeshtë në klasë] *Journal of Educational Research*, [Revista Shkencore e Kërkimit në Arsim] 85(2), 89—99.
- Bangert-Drowns, R. L., Kulik, C. L., Kulik, J. A., & Morgan, M. T. (1991). The instructional effect of feedback in test-like events. [Efekti i reagimit bazuar në udhëzime në situata të ngjashme me testimin] *Review of Educational Research* [Analizë e Kërkimit në Arsim], 61, 213—237.
- Bargh, J. A., Gollwitzer, P. M., Lee-Char, A., Bamdollar, K., & Trötschel, R. (2001). The automated will: Nonconscious activation and pursuit of behavioral goals. [Vullneti i automatizuar: aktivizimi i pandërgjegjshëm dhe ndjekja e qëllimeve të sjelljes] *Journal of Personality and Social Psychology* [Revista Shkencore e Psikologjisë Sociale dhe të Personalitetit], 81(6), 1014—1027.
- Bennett, N., & Kell, J. (1989). *A good start? Four year olds in infant schools*. [Një fillim i mbarë? Katërvjeçarët në parashkollor.] Oksford, MB: Blackwell.
- Berglas, S., & Jones, E. (1978). Drug choice as a self-handicapping strategy in response to noncontingent success. [Zgjedhja e drogave si një strategji vetë-kufizuese në përgjigje të reagimit të fryrë në krahasim me performancën] *Journal of Personality and Social Psychology* [Revista Shkencore e Psikologjisë Sociale dhe të Personalitetit], 36, 405—417.
- Black, P., & William, D. (1998). Assessment and classroom learning. [Vlerësimi dhe mësimnxënia në klasë] *Assessment in Education* [Vlerësimi në Arsim], 5(1), 7—75.
- Blöte, A. W. (1995). Students' self-concept in relation to perceived differential teacher treatment. [Vetë-koncepti i nxënësve lidhur me trajtimin e perceptuar si diferencial të mësuesit] *Learning & Instruction* [Mësimdhënia dhe udhëzimi], 5(3), 221—236.
- Bond, L., Smith, R., Baker, W. K., & Hattie, J. A. (2000) *Certification system of the National Board for Professional Teaching Standards. A construct and consequential validity study*. [Sistemi i Certifikimit nga Bordi Kombëtar për Standardet e Mësimdhënies Profesionale. Një studim i vlefshmërisë konstruktive dhe

- ndikuese.] Uashington, DC: Bordi Kombëtar për Standardet e Mësimdhënies Profesionale.
- Brackbill, Y., Blobitt, W. E., Davlin, D., & Wagner, J. E. (1963). Amplitude of response and the delay-retention effect. [Madhësia e përgjigjes dhe efekti i ruajtës së vonshme] *Journal of Experimental Psychology* [Revista Shkencore e Psikologjisë Eksperimentuese], 66 (1), 57—64.
- Breakwell, G. M. (1983). Formulations and searchers. [Formulime dhe kërkues] Në G. M. Breakwell (Red.), *Threatened identities* [Identitete të kërcënuara] (fq. 3—26). Chichester, MB: Wiley.
- Brockner, J. (1979). The effects of self-esteem, success-failure, and self-consciousness on task performance. [Efektet e vetë-vlerësimit, suksesit-dështimit dhe vetë-ndërgjegjësimit në performancën e detyrave] *Journal of Personality and Social Psychology* [Revista Shkencore e Psikologjisë Sociale dhe të Personalitetit], 37, 1732—1741.
- Brockner, J., Derr, W. R., & Laing, W. N. (1987). Self-esteem and reactions to negative feedback: Towards greater generalizability. [Vetë-vlerësimi dhe reagimet ndaj vlerësimit negativ: Drejt një përgjithshmërie më të madhe.] *Journal of Research in Personality* (Revista Shkencore e Hulumtimit të Personalitetit), 21, 318—334.
- Brophy, J. (1981). Teacher praise: A functional analysis. [Lavdërimi i mësuesit: një analizë funksionale] *Review of Educational Research* [Analizë e Kërkimit në Arsim], 51, 5—32.
